



- Lejon individët që të zbulojnë ç’po ndodh me informacionin e tyre dhe të kërkojnë ndreqjen e tij nëse gjërat shkojnë keq.
- Krijon një organizëm të pavarur, të quajtur Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, puna e të cilit është që të sigurohet që po vepron në përputhje me ligjin.

Cilat janë rregullat për organizatat?

Ligji ka karakter teknik dhe si i tillë është i ndërlikuar. Por, në thelb, rregullat nënkuptojnë që organizatat duhet të sigurohen që informacioni të përdoret vetëm për qëllimin e synuar; që ai të jetë i saktë dhe në përputhje me qëllimin, e që të jetë i sigurt. Organizatat duhet gjithashtu të sigurohen se individët janë në dijeni të përdorimit të informacionit për ta.

Si mund ta mësoj çfarë po ndodh me informacionin tim?

Ligji ju jep të drejtën që të shihni informacionin që organizatat mbajnë për ju. Gjithçka që duhet të bëni, është të kontaktoni organizatën dhe të pyesni. Kërkesa duhet të jetë me shkrim, por nuk përfshin asnjë pagesë. Ju keni të drejtën që t’ju thuhet nëse organizata po përdor informacion rreth jush. Nëse kjo ndodh, keni të drejtë që ta shikoni vetë informacionin, për shembull në formën e një kopjeje në letër apo në ndonjë formë tjetër që është e volitshme për ju. Organizata duhet të përgjigjet brenda 30 ditëve. (Duhet gjithashtu të dini që kjo e drejtë përmban edhe disa përjashtime të kufizuara).

Ç’mund të bëj nëse informacioni për mua është i gabuar apo po keqpërdoret?

Nëse informacioni për ju është i pasaktë apo përdoret në mënyrë të paligjshme, keni të drejtën që

ta korrigjoni apo ta fshini. Organizata duhet ta bëjë këtë brenda 30 ditëve nga kërkesa juaj dhe duhet t’ju njoftojë për veprimin e kryer.

Ç’mund të bëj nëse organizata nuk më përgjigjet?

Nëse rast se organizata nuk i përgjigjet kërkesës suaj fillestare apo nuk i bën ndryshimet që ju kërkoni, ju mund të ankoheni tek Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Për këtë, nuk duhet të paguani asgjë. Komisionerja ka autoritetin që të kryejë një hetim dhe ti kërkojë organizatës që të ndërmarrë veprimet e duhura.

SI TË KONTAKTOSH KOMISIONEREN PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave është organi përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjit “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Komisionerja është plotësisht e pavarur. Kompetencat e saj ushtrohen tek të gjithë organizatat, përfshirë qeverinë. Një prej funksioneve të saj të rëndësishme është trajtimi i ankesave që vijnë nga individët. Për këtë, individët nuk duhet të kryejnë asnjë pagesë.

Rr. Abdi Toptani (Prane Drejtorise se Pergjithshme te Burgjeve), Tirane

Kjo fletëpalosje u botua në kuadër të projektit "Mbrojtja e të Dhënave Personale në Shqipëri" i implementuar nga Këshilli i Evropës, nën mbikëqyrjen e projektit "Modernizimi i sistemeve të adresave dhe regjistrimit civil" i Prezencës në Shqipëri të OSBE-së, financuar nga Komisioni Evropian.



JU VIJMË NË NDIHMË PËR TË MBROJTUR TË DHËNAT TUAJA PERSONALE



INFORMACIONI PERSONAL

Çfarë është informacioni personal?

Informacioni personal është çdo lloj informacioni për ju, që përfshin të dhëna të cilat ndihmojnë në identifikimin tuaj si për shembull, emri, moshë, gjinia, adresa, kombësia dhe shtetësia. Por mund të përfshijë gjithashtu informacion për gjërat që ju bëni, ku udhëtoni, artikujt që bleni, veprimet që kryeni në bankë, sjelljen tuaj në punë ose në shkollë.

Kush e mbledh këtë informacion?

Të gjitha organizatat mbledhin informacion personal. Për shembull, qeveria dhe bashkitë e mbledhin informacionin për të dhënë shërbimet publike; policia e mbledh për të parandaluar dhe luftuar kriminalitetin; mjekët e mbledhin për të kuruar; kompanitë e telefonisë celulare e mbledhin për t'u dërguar faturat klientëve; punëdhënësit e mbledhin për të monitoruar ecurinë e personelit. Ka edhe shumë shembuj të tjerë.

Nga e marrin organizatat informacionin?

Shpesh, nga vetë njerëzit. Për shembull, kur shkoni në bankë për të hapur një llogari, kur shkoni në një kompani sigurimesh apo tek mjeku, ju kërkojnë informacion mbi veten. Mënyrat e tjera janë më pak të dukshme. Për shembull, sa herë që përdorni celularin, vizitoni një faqe interneti apo përdorni kartën e kreditit, juve i jepni informacion ofruesit të shërbimit. Ka raste kur organizatat mbledhin informacion për njerëzit nga organizata të tjera. Për shembull, nëse prenotoni një fluturim nëpërmjet një agjencie, kjo e fundit do t'ia kalojë informacionin për ju, linjës ajrore.

Ç'probleme mund të lindin?

Normalisht, nuk lindin probleme. Pjesa më e madhe e organizatave e përdorin informacionin personal në mënyrë të përgjegjshme, për të dhënë shërbimin që njerëzit kërkojnë. Por, gjërat mund edhe të mos shkojnë mbarë. Për shembull, nëse informacioni juaj është i pasaktë, mund të mos e fitoni punën që dëshironi apo t'ju mohohet një përfitim nga shteti në rastin kur ju takon. Informacioni juaj mund të humbasë apo të vidhet, gjë që do të thotë se njerëz të paautorizuar mund ta shtien atë në dorë dhe ta përdorin për qëllime të dëmshme.

LIGJI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Si mund të ndihmojë ligji?

Tre janë gjërat kryesore që bën ligji:

- Vendos rregullat që duhet të ndiqen nga organizatat që përdorin informacionin personal.



Të gjitha organizatave u nevojitet informacion për njerëzit në mënyrë që të japin shërbimet që njerëzit duan. Qeveria, bashkitë, mjekët, shkollat, bankat, kompanitë e sigurimit, kompanitë e telefonisë celulare, ofruesit e shërbimit të internetit, agjencitë e udhëtimit, dyqanet e shumë të tjerë mbledhin informacion personal. Informacioni është i domosdoshëm për drejtimin e një shoqërie moderne.

Pjesa më e madhe e organizatave e përdorin informacionin në mënyrë të përgjegjshme, por, gjërat mund të mos shkojnë mirë dhe nëse kjo ndodh, njerëzit në fjalë mund të dëmtohen.

Një ligj i ri – ligji nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” –tani ju ndihmon që të mbron informacionin tuaj personal. Kjo fletëpalosje përmban informacion mbi këtë ligj dhe ju shpjegon ç'mund të bëni nëse keni një shqetësim.

SHËNIM I RËNDËSISHËM: Kjo fletëpalosje nuk përmban një ekspozitë të plotë të ligjit. Nëse keni dyshime, duhet të pyesni Komisioneren për Mbrojtjen e të Dhënave (shiko faqen prapa) apo të kërkontë këshillim ligjor.